



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:147244

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05799968

K.DH.SH.II.nr.639/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Saranda Bogaj Sheremeti kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së të paditësit Fertrans Sh.P.K, me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Kushtrim Bytyqi, nga Prishtina, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.68/22 i datës 05.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 31.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.68/22 i datës 05.02.2024, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Dhoma e Shkallës së Parë, me aktgjykimin e ankimuar, nën pikën I. të dispozitivit ka vendosur, **APROVOHET** si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit me Fertrans Sh.P.K, me seli në Ferizaj, **ANULOHET** vendimi nr. 316/2020 të datës 16.10.2020, i Departamentit të Ankesave i

Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë , lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE dhe secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimit, në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura , me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të; konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve procedurale dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, të anulohet aktgjykimi KF.nr.68/22 i datës 05.02.2024i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal dhe vendimi nr. 316/2020 të datës 16.10.2020 i Departamentit të Ankesave-Administratës Tatimore të Kosovës. Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Pala paditëse nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është **e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se, e paditura me vendimin nr.316/2020 i datës 16.10.2020, ka refuzuar ankesës e këtu paditësit në procedurë administrative.

I pakënaqur me vendimin e ATK-së, subjekti ushtron padi në Gjykatë, në procedurë të konfliktit administrativ. Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti Fiskal pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 05.02.2024 në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse e në mungesë të palës së paditur, pas vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit, e anulon vendimin nr.316/2020 i datës 16.10.2020 të Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Gjykata në shkallë të parë ka konstatuar se e paditura në vendimin kontestues është mjaftuar me referime të bazës ligjore ndërsa me vetëm nja paragraf ku thotë se

: për periudhën, për blerjet nga importi 2016 periudha kohore e transaksionit KMSH 01.01-01.06.2016 është trajtuar bazuar në vendimin shpjegues publik nr. 04/2014 dhe prej 02.06.2016-31.12.2017 është respektuar me kontroll vendimi shpjegues publik nr. 3/2016 për Vlerësimet dhe Rivlerësimet doganore, ka dhënë arsyetim për gjendjen faktike të vërtetuar dhe aplikim të së drejtës materiale.

Gjykata në shkallë të parë konstaton se ligji 05/L-031, në nenin 47, ka të përcaktuar Strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar, e ku sipas këtij neni akti administrativ i shkruar përmban, në paragrafin 1.3. të tije edhe : 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin);, ndërsa në vazhdim neni 48, shprehimisht përcakton se arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ, dhe sipas këtij neni Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij. Tutje neni 52, parag 1. i këtij ligji përcakton shprehimisht se *Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: nën paragrafi 1.4 është nxjerr në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrative.* Nga Interpretimi i drejtë i këtyre dispozite dhe nga dispozitivi i vendimit kontestues del se i njëjti përveç që ka një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij, i njëjti është edhe i paligjshëm sipas nenit 52, parag 1, nën parag 1.4 të Ligjit 05/L-031.

Dhoma e shkallës së parë vlerëson se e paditura para se të thirret në vendimet shpjeguese publike nr. 04/2014 dhe 03/2016, fillimisht duhet të analizoj bazën ligjore në fuqi që rregullon këtë materie dhe vetëm pas interpretimit dhe zbatimit të drejtë të së drejtës materiale të konstatoj saktë gjendjen faktike duke u referuar në periudha përkatëse të kontrollit dhe duke cekur të dhënat e pranuar nga palët e treta, duke listuar DUD-at përkatës që janë marrë për bazë për vlerësim tatimor, respektivisht aplikim të KMSH-së, duke evidentuar faturat përkatëse të këtyre DUD-ve, dhe duke lidhur të njëjtit me pagesat bankare ndërkombëtare me referenca të sakta për faturat e DUD-ve kontestues, dhe vetëm pas kësaj dhe mbi bazën e kësaj të marr veprime konkrete.

Tutje shkalla e parë ka vlerësuar se paditura në rivendosje duhet të ketë parasysh edhe faktin se sipas nenit 9, par 4, të Ligjit 03/L-222, një vendim shpjegues publik nuk është detyrues për personin i cili është i detyruar të paguajë tatime në bazë të legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë. Por se i njëjti i shërben ATK-së për të sqaruar se si ATK-ë do të interpretojë dhe zbatojë dispozitat e legjislacionit që administron me qëllim që t'u sigurojë udhëzime personave që kërkohet të paguajnë tatimin ose t'u mbahet tatimi në burim.

Dhoma e Shkallës së Dytë duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, i pranon në tërësi si të drejta dhe ligjore konkludimet juridike të Dhomës së Shkallës së Parë, sa i përket gjendjes faktike të çështjes, e gjithashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i ekzaminon sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe 194 të LPK. Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë, drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, si dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është e bazuar, duke e anuluar vendimin nr. 316/2020 të datës 16.10.2020 të Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Pretendimet ankimore të paditurës nga bazat ankimore të theksuara si më lartë si dhe pretendimet e tjera si në arsyetim të ankesës, kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, sepse nuk janë të bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara, andaj kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, përgjigjen në padi pastaj ka caktuar seancë të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme e që kuptohet se gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së. Dhoma e shkallës së parë, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative në vështrim të nenit 43 paragrafi 2, të LKA-së. në bazë të këtij parimi Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit e anulon vendimin e kontestuar dhe lëndën e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 paragrafi 2 dhe 65 të LKA-së e detyron të paditurën që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të aktgjykimit.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.639/24, me datë 31.05.2024

Kryetare e kolegjit,

Saranda Bogaj Sheremeti